



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 prill 2012
Nr. ref.: RK226/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI160/11

Parashtruesi

Agjencia Kosovare e Privatizimit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës
Supreme të Kosovës ASC-09-0106, të datës 7 tetor 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), e përfaqësuar nga Zyrtari i lartë ligjor i AKP-së, z. Gani Ademi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) ASC-09-0106, të 7 tetorit 2011, i cili i ishte dorëzuar më 18 tetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i lartpërmendur ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 102.3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] si dhe nenin 6 [E Drejta për Gjykim të Drejtë] të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga gjykata që të vendos masat e përkohshme për të ndaluar ekzekutimin e Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme ASC-09-0106, për arsyen se, *“Ekziston rreziku që paditësi të kërkoj përmbarimin e dhunshëm të aktgjykimit ASC-09-0106, dhe në këtë mënyrë të shkaktohen dëme të pariparueshme për të paditurën dhe të cenohet interesi publik. Njëherësh, pasi që e tërë procedura publike e tenderimeve gjatë procesit të privatizimit e vendosur me ligjin e zbatueshëm, mundet të perceptohet negativisht nga publiku dhe të bie numri i pjesëmarrësve në tender.”*

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 dhjetor 2011, parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 17 janar 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.
8. Më 6 shkurt 2012, kërkesa iu komunikua Dhomës së Posaçme.
9. Më 19 prill 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Në vitin 2006, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM) tenderoi shitjen e New Co “Jugoterm” në Gjiilan.
11. Më 14 nëntor 2006, një nga ofertuesit, z. Sh. A, u ankua në Dhomën e Posaçme duke kërkuar anulimin e procedurës së tenderit sepse, gjoja, kishte marrëveshje të fshehta me ofertuesve, pjesë e cilës marrëveshje ishte edhe ai vetë, kështu që ishin shkelur rregullat e tenderimit.

12. Më 8 gusht 2007, Dhoma e Posaçme nxori një aktgjykim (Aktgjykimin SCC-06-0475), me të cilin pjesërisht pranoi kërkesën. Dhoma e Posaçme obligoi AKM-në që ta anulojë tenderin në të cilin Ndërmarrja Publike "Eng Office" ishte shpallur fituese e shitjes së New Co "Jugoterm", sepse Dhoma e Posaçme kishte gjetur parregullsi në procedurën e tenderimit. Pjesa e kërkesës përmes së cilës është kërkuar nga Dhoma e Posaçme që të urdhëroi AKM-në të organizojë tender të ri për New Co e lartpërmendur, ishte refuzuar sepse varej nga AKM-ja që të vendoste për tenderim të ri apo jo.
13. Ofertuesi "Eng Office", i cili kishte blerë New Co "Jugoterm", kërkoi nga njëjta, Dhoma e Posaçme, që të shqyrtonte Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të 8 gushtit 2007.
14. Më 5 shkurt 2008, e njëjta, Dhoma e Posaçme (Vendimi SCA-08-0007), refuzoi kërkesën e "Eng Office" për shqyrtim me arsyetimin se nuk ishte ngritur asnjë pretendim i ri ose faktik dhe se Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme i 8 gushtit 2007 ishte në pajtim me ligjin në fuqi. Ky vendim ishte i formës së prerë dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të ushtrohej ankesë ndaj tij.
15. Më 3 mars 2008, "Eng Office" i parashtroi ankesë Dhomës së Posaçme kundër AKM-së për shkeljen e rregullave të tenderimit dhe propozoi se duhej obliguar AKM-në për nënshkrimin e marrëveshjes me "Eng Office" si fitues në procesin e ofertimit dhe të paguaj kompensim për dëmet materiale dhe jo-materiale.
16. Ndërkohë, më 21 maj 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi) kaloi Ligjin Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP). Neni 1 i Ligjit për AKP thotë se "Agjencia themelohet si organ i pavarur publik..." dhe "...është pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM) rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 'për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit' (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12), me ndryshime, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e kësaj të fundit do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë." Për më tepër, neni 31 paragrafi 1 i Ligjit për AKP parasheh se Ligji për AKP "do të mbisundojë çdo dispozitë tjetër të Ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të", përderisa në paragrafin 2 thuhet se "Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, me ndryshimet dhe plotësimet e saj, nuk do të prodhojë efekte juridike pas hyrjes në fuqi të këtij ligji".
17. Më 22 tetor 2009, Trupi Gjyqësor i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Trupi Gjyqësor) pjesërisht pranoi ankesën e "Eng Office". Trupi Gjyqësor konkludoi (Aktgjykimi SCC-08-0056) se "Eng Office" është ofertuesi fitues, obligoi AKM-në dhe AKP-në të gjejë mënyrën dhe procedurën për të përmbyllur tenderin, si dhe obligoi AKM-në të paguante kompensim për dëmet materiale. Në bazë të dëshmive të paraqitura Trupi Gjyqësor arriti në përfundim se anulimi i bërë nga Drejtori Gjeneral nuk është i vlefshëm sepse Bordi i Drejtorëve është organi i vetëm i autorizuar për anulimin e tenderëve. Më tej, Trupi Gjyqësor konkludoi se ky rast nuk mund të konsiderohet *res judicata* sepse palët në Aktgjykimin SCC-06-0475, të 8 gushtit 2007, ishin tjera nga ato në këtë rast dhe se kërkesa gjithashtu ishte tjetër.
18. Më 17 dhjetor 2009, AKP-ja i paraqiti ankesë Kolegjit të Apelit kundër Aktgjykimit të 22 tetorit 2009, sepse aktgjykimi shkel parimin e *res judicata*.
19. Më 7 tetor 2010, Kolegji i Apelit (Aktgjykimi ASC-09-0106) refuzoi ankesën e AKP-së si të pabazë dhe mbështeti Aktgjykimin e Trupit Gjyqësor të 22 tetorit 2009 (Aktgjykimi ASC-08-0056). Kolegji i Apelit vendosi se "Për shkak të faktit se Paditësja e lëndës në fjalë nuk ka qenë palë e procesit gjyqësor të mëparshëm dhe meqë kompania nuk i ka pasur mundësitë e rregullta për të prezantuar dëshmi që e mbështesin qëndrimin e saj dhe të përdorë mjetet e zakonshme që janë në dispozicion të palës në procedurë,

nga këto çështje plotësisht procedurale duhet të nxirret përfundimi se aktgjykimi i mëparshëm nuk mund të parandalojë shqyrtimin e padisë së Paditëses ENG Office SHPK.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

I. Sa i përket statusit ligjor të AKP-së

20. Parashtruesi i kërkesës pohon se Dhoma e Posaçme ka shkelur Ligjin për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 03/L-067), të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, ligj ky në fuqi, si dhe nenin 102 të Kushtetutës, me njohjen e statusit ligjor të AKM-së para Dhomës së Posaçme.
21. Sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, Dhoma e Posaçme është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe se ka për obligim zbatimin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Me Aktgjykimin ASC-09-0106, AKM-së i është njohur statusi ligjor dhe e drejta për të qenë palë para Dhomës së Posaçme, edhe pse AKM-ja si entitet ka mbaruar së ekzistuari me Ligjin Nr. 03/L-067. Vendimi ekzekutiv i UNMIK-ut nr. 2008/34, i 29 qershorit 2008, tregon se aktivitetet e AKM-së kanë mbaruar *de facto* dhe *de jure*.
22. Pretendohet se Dhoma e Posaçme në aktgjykimet e mëparshme ka vendosur që AKP-ja mund të përfaqësojë ndërmarrjet shoqërore para Dhomës së Posaçme, vetëm nëse AKM-ja nuk ushtron të drejtën e përfaqësimit të ndërmarrjeve shoqërore, apo nuk e ka një të drejtë të tillë. Rrjedhimisht, pretendohet se kjo është në kundërshtim me ligjin në fuqi në Kosovë, Ligji Nr. 03/L-067.

II. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të parimit *res judicata*

23. Më tej, parashtruesi i kërkesës pohon se me Aktgjykimin SCC-08-0056 dhe ASC-09-0106, Dhoma e Posaçme ka vendosur për një çështje ligjore mbi të cilën është vendosur më parë me Aktvendimin SCC-06-0475, të 8 gushtit 2007. Prandaj, pretendohet se Dhoma e Posaçme e ka shkelur parimin *res judicata*, pasi që objekt në Aktgjykimin SCC-06-0475 e 8 gushtit 2007 dhe atë SCC-08-0056 të 22 tetorit 2009 ishte çështja e tenderit të publikuar nga AKM-ja për privatizimin e New Co “Jugoterm”. Në rastin e parë, SCC-06-0475 të 8 gushtit 2007, Dhoma e Posaçme nxori vendimin për anulimin e tenderit, përderisa në rastin e dytë, SCC-08-0056 të 22 tetorit 2009, nxori vendimin me të cilin kërkonte mbylljen e tenderit me nënshkrimin e marrëveshjes për shitje.
24. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se Dhoma e Posaçme në mënyrë indirekte edhe vetë e pranon se po shqyrton një çështje të gjykuar:

“...
i)

Në aktgjykimin SCC-08-0056 (fq. 10), DHP ka theksuar se Aktgjykimi SCC-06-0475, është marrë nën ndikimin e këtyre rrethanave:

“Dhoma e thekson faktin se në atë kohë ka qenë e informuar me anë të një letre që Bordi i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit e kishte anuluar tenderin. Kjo del se është një deklaratë e rrejshme”. Vazhdon me konstatimin tjetër se: “Mbase do të kishte qenë e udhës që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AKM-në ta ftonte në gjykim ofertuesin fitues të përkohshëm, saktësisht ENG Office, Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit rreth anulimit të tenderit”.

dhe

- ii) Në aktgjykimin ASC-09-01/06 (faqja e fundit) Dhoma e Posaçme ka theksuar se në rastin SCC-06-0475, ENG Office nuk ka qenë palë në procedurë andaj edhe nuk ka pasur mundësi që të paraqes mbrojtjen e saj, prandaj nuk duhet t'i ndalohe procesi i ri gjyqësor.
- ...

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Gjykata vëren se parashtruesit ankohen për dy çështje:
- i. Statusin ligjor të AKP-së;
 - ii. Shkeljen e parimit *res judicata*.
26. Lidhur me këtë, për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë, specifikuar me Ligjin për Gjykatës Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.

I. Sa i përket statusit ligjor të AKP-së

27. Gjykata Kushtetuese ka vendosur lidhur me statusin ligjor të AKP-së në Aktgjykimin e Rastit Nr. KI. 25/10.
28. Gjykata vlerësoi se “Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (...) nuk e ka konsideruar Ligjin Nr. 03/L-067 si ligj, drejtësisht i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, por si rregulla të brendshme të vlefshme dhe të detyrueshme të organizatës së AKP-së, që e karakterizoi si entitet faktik, në vend të një organi publik të pavarur me zotësi të plotë juridike, siç është përcaktuar në Ligjin Nr. 03/L-067.”
29. Gjykata Kushtetuese konkludoi se, “duke mos zbatuar Ligjin 03/L-067 për AKP-në, sipas rregullit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, Dhoma e Posaçme me veprimet e saj ka shkelur nenin 102 të Kushtetutës”.
30. Prandaj, kjo nuk do të trajtohet në këtë rast në pajtim me rregullin 36(3) (e) të Rregullores së punës, ku parashihet: “një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet kur: Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri”.

III. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të parimit *res judicata*

31. Sa i përket shkeljes së parimit *res judicata* Gjykata thekson se sipas Kushtetutës, Gjykata nuk është për të vepruar si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta.
32. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis*, García kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
33. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kërkesës ka pasur gjykim të drejtë (shih, për

shembull, Raporti i Komisionit Evropian për të drejtat e njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87, të miratuar më 10 korrik 1991).

34. Në rastin konkret, parashtruesi kërkesës thjeshtë konteston konstatimet e gjykatave lidhur me rastin dhe cek disa dispozita ligjore të Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane si të shkelura me vendimin e kontestuar të Dhomës së Posaçme. Sidoqoftë, parashtruesi i kërkesës nuk sqaron se si dhe pse Dhoma e Posaçme ka shkelur këto dispozita, që do të thotë se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur rastin mbi bazën e kushtetutshmërisë.
35. Si përfundim, parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon se procedurat para Dhomës së Posaçme ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
36. Rregulli 36 (2) d) i Rregullores parasheh se *“Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se (...) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”*.
37. Prandaj, duke pasur parasysh vlerësimet e mësipërme, rrjedhë se kërkesa si tërësi duhet refuzuar si qartazi e pabazuar.

Vlerësimi i kërkesës për masa të përkohshme

38. Neni 27 i Ligjit dhe, në veçanti, rregulli 54 (1) i Rregullores së punës, parasheh se *“Në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme”*. Sidoqoftë, kur kemi parasysh se kërkesa ishte e papranueshme, parashtruesi i kërkesës nuk gëzon të drejtën nga rregulli 54(1) i Rregullores së punës, për kërkimin e masës së përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me rregullat 36(3) (e), 36 (3) (d), 54 (2) dhe 56 (2) të Rregullores së punës të 19 prillit 2012, njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TË HEDHË POSHTË kërkesën për masa të përkohshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodriguez

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani